


Promovojmë
Transparencën

Mbrojmë
të Dhënat
Personale



KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

INFORMIM DHE PRIVATËSI

Revista Nr. 13

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| Indeksi i Transparencës së Autoriteteve Publike | faqja 3 |
| Legjislacioni i mbrojtjes së të dhënave personale në Ballkanin Perëndimor | faqja 3 |
| 28 Janar, Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale | faqja 4 |
| Konventat 108+ dhe 205 të KiE, modernizohet legjislacioni shqiptar | faqja 4 |
| A i mbrojmë të dhënat personale? Forum në Universitetin Europian të Tiranës | faqja 5 |
| Transparenca proaktive e Autoriteteve Publike, përmbushje të detyrimeve për forcimin e llogaridhënies | faqja 5 |
| Konferenca “Parandalimi i korrupsionit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar” | faqja 6 |
| “Ditët e Transparencës” me Autoritete Publike të Lezhës, Elbasanit, Beratit dhe Kukësit | faqja 6-7 |
| Konsultimi për përmirësimet në ligjin “Për të drejtën e informimit” | faqja 8 |
| Kuvendi miraton rezolutën për vlerësimin e punës të Zyrës së Komisionerit për vitin 2021 | faqja 8 |
| Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit me Agjencinë për Informim dhe Privatësi të Kosovës | faqja 9 |
| Konferenca “Mos u rrej! Dita Ndërkombëtare e Verifikimit të Fakteve në Shqipëri” | faqja 10 |
| Bashkëpunimi me shoqërinë civile për zbatimin e të drejtës për informim | faqja 10 |
| Prezantimi i rezultateve të Pyetësorit | faqja 11 |
| Konsolidim i rolit të institucionit për garantimin e të drejtave të qytetarëve | faqja 12 |
| Workshop me shoqatën DIHA, për të zbatimin e të drejtave në fushën e biznesit | faqja 12 |
| Zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale detyrim për çdo kontrollues | faqja 13 |
| Procesi i negociatave për anëtarësimin në BE, vlerësohet kontributi i Zyrës së Komisionerit | faqja 14 |
| Të informuar e ndërgjegjësuar, takime me studentë | faqja 14 |
| Zyra e Komisionerit organizatore e edicionit të 15-të ICIC | faqja 15 |
| “Aksesi në informacion, pjesëmarrja dhe përfshirja në epokën digjitale”, Konferenca e 13-të e ICIC | faqja 16 |
| Bashkëpunimi rajonal në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, takim i autoriteteve në Prishtinë | faqja 17 |
| Komisioneri në media | faqja 18 |

Revista “Informim Dhe Privatësi”

Redaksia: Redi Skënderaj, Alketa Koja, Segi Berberi, Denada Hysi, Brikena Tepelena.

INDEKSI I TRANSPARENCËS SË AUTORITETEVE PUBLIKE



Zyra e Komisionerit ka realizuar, për vitin e dytë radhazi, Raportet mbi “Indeksin e transparencës së autoriteteve qendrore dhe të varësisë 2021” dhe “Indeksin e transparencës së njësive të vetëqeverisjes vendore 2021”. Këto dokumente ndjekin një metodologji të caktuar, e cila shërben kryesisht për të sjellë një analizë krahasuese të nivelit të transparencës proaktive të autoriteteve publike

duke krahasuar prirjen e transparencës së tyre ndër vite. Nga monitorimi i realizuar, në raport me vitin e kaluar, konstatohet një rritje e transparencës proaktive në autoritetet publike qendrore dhe të varësisë, si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore, përsa i përket plotësimit të Programit të Transparencës në të gjithë elementet e tij, si dhe përsa i përket Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve. Gjetjet e këtyre raporteve synojnë jo vetëm të nxisin ndërgjegjësimin për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, ashtu si edhe rritjen e nivelit të transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por shërbejnë dhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.

LEGJISLACIONI I MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Qendra Kërkimore për Ligjin dhe Digjitalizimin në Fakultetin Juridik të Universitetit të Passaut në Gjermani (University of Passau Faculty of Law’s Research Center for Law and Digitalisation-FREDI) organizoi një seri diskutimesh për kuadrin rregullator të mbrojtjes së të dhënave personale në vendet e Ballkanin Perëndimor (Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia). Në këto aktivitete morën pjesë përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse, përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile apo sektorë të ndryshëm të biznesit, akademikë, studiues e studentë. Zyra e Komisionerit u përfaqësua, në takimin për Shqipërinë, me znj. Besa Velaj, Drejtore e Kabinetit. Në fokus të tij ishte procesi i modernizimit të legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale duke e përafuar tërësisht atë me GDPR dhe Direktivën e Policisë dhe ndikimi i tij në zhvillimin e ekonomisë.

Pjesëmarrësit u njohën edhe me rolin dhe veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për monitorimin dhe mbikëqyrjen efektive të legjislacionit në fuqi gjatë viteve të fundit apo rritjen e ndërgjegjësimin për ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve. Organizimi i këtyre aktiviteteve nga Universiteti i Passaut kishte si qëllim identifikimin dhe krahasimin e qasjeve rajonale dhe kombëtare për zbatimin e kuadrit rregullator të fushës, si dhe përpjekjet për modernizimin e tij sipas modelit evropian.





28 JANAR, DITA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Në 28 Janar – Ditën Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit lançoi iniciativën e një pyetësori për kontrolluesit publik që përpunojnë të dhëna personale të qytetarëve. Ky pyetësor ka për qëllim të vlerësojë njohuritë e administratës publike në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave

personale, si dhe kriteret e normat për përpunim e ligjshëm të tyre. Nëpërmjet tij, autoriteti do të ketë informacion të bollshëm për nivelin e njohurive të administratës për këtë të drejtë kushtetuese të qytetarëve dhe për zbatimin e detyrimeve që parashikon kuadri ligjor në fuqi. Informacioni i përfutur i mundëson Zyrës së Komisionerit, nga ana tjetër, evidentimin e problematikave më të rëndësishme si dhe nevojat për zhvillim të mëtejshëm profesional të nëpunësve të këtyre institucioneve. Pyetësori ishte i strukturuar në 21 pyetje me disa përgjigje alternative dhe u shpërnda në 121 institucione të administratës shtetërore/publike.

KONVENTAT 108+ DHE 205 TË KiE, MODERNIZOHET LEGJISLACIONI SHQIPTAR

Shqipëria nënshkroi protokollet e Konventave 108+ dhe 205 të Këshillit të Evropës (KiE), dy dokumente të rëndësishme për forcimin e shtetit ligjor, demokracisë dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.



Akti i parë është ratifikimi i Protokollit (CETS No. 223) për modernizimin e Konventës “Për mbrojtjen e individëve nga procedimi automatik i të dhënave personale”, e njohur ndryshe si Konventa 108+ e KiE. Ky dokument është instrumenti më i vjetër me fuqi detyruese për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë në hapësirën evropiane, por dhe më gjerë. Përmirësimi i Konventës i përgjigjet sfidave të zhvillimit ekonomik e shoqëror, por sidomos atij teknologjik, duke zbatuar standardet më të larta në garantimin e të drejtave të individit. Ky modernizim mban të njëjtën frymë me reformën e kësaj fushe në Bashkimin Evropian, miratimin dhe zbatimin e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) dhe Direktivën e Policisë. Ky akt është bërë pjesë e legjislacionit kombëtar me miratimin nga Kuvendi të ligjit nr. 49/2022, datë 12.05.2022.

Akti i dytë është ratifikimi i Konventës 205/2009 “Mbi aksesin në dokumente zyrtare”, duke hedhur një hap të rëndësishëm në plotësimin e legjislacionit shqiptar të të drejtës për informim. Dokumenti garanton zbatimin e standardeve më të përparuara evropiane për aksesin në informacion që prodhojnë ose mbajnë autoritetet publike. Nga ana tjetër, transparenca proaktive e tyre është një tipar kyç i qeverisjes së mirë, të hapur dhe të përgjegjshme, për rritjen e besimit të publikut dhe cilësisë së shërbimeve. Ky akt është bërë pjesë e legjislacionit shqiptar me miratimin nga Kuvendi të ligjit nr. 45/2022, datë 28/04/2022 . Kuadri rregullator i të drejtës për informim është plotësuar edhe me miratimin e ligjit nr. 33/2022, datë 31.03.2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, që ka transpozuar Direktivën e BE me të njëjtën emërtesë, e që hyn në fuqi pranverën e vitit 2023.

A I MBROJMË TË DHËNAT PERSONALE? FORUM NË UNIVERSITETIN EUROPIAN TË TIRANËS

Komisioneri ishte i ftuar në Forumin me temë “A i mbrojmë të dhënat personale?”, organizuar nga Universiteti Europian i Tiranës, në kuadër të aktiviteteve për Ditën Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Z. Dervishi, në përgjigje



të interesit të të pranishmëve vlerësoi se kultura dhe ndërgjegjësimi në vendin tonë për mbrojtjen e të dhënave personale është përmirësuar ndjeshëm, por ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim. Ai prezantoi veprimtarinë e institucionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi në garantimin e kësaj të drejte themelore të qytetarëve dhe ofroi këshilla praktike. Komisioneri theksoi se

përgjegjshmëria, transparenca, etika dhe siguria janë disa prej kriterëve më të rëndësishme për një proces të ligjshëm të përpunimit të të dhënave nga kontrolluesit publik apo privat.

TRANSPARENCA PROAKTIVE E AUTORITETEVE PUBLIKE, PËRMBUSHJE TË DETYRIMEVE PËR FORCIMIN E LLOGARIDHËNIES

Programi i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve janë nga elementët e rëndësishëm të transparencës proaktive dhe tregues i përgjegjshmërisë e llogaridhënies së autoriteteve publike. Zyra e Komisionerit zhvilloi një takim me koordinatorë të institucioneve qendrore e të varësisë dhe atyre të pavaruara, ku paraqiti problematikat e konstatuara në Raportin mbi “Indeksin e transparencës së autoriteteve qendrore dhe të varësisë 2021”, të publikuar në fillim të vitit 2022. Nga monitorimi dhe analiza e situatës vlerësohet se kërkohet një dinamikë e re në përmbushjen e detyrave nga koordinatorët dhe rritje e cilësisë së procesit të trajtimit në kohë dhe në objekt të kërkesave për informacion të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Vëmendje duhet t’i kushtohet përditësimit



periodik të Programit dhe Regjistrit, duke qenë se përbëjnë nga burimet kryesore për marrjen e dokumentacionit publik. Në këtë kontekst, informacionet rreth përmbajtjes së shpenzimeve buxhetore, procedurave të prokurimit publik apo auditimeve ndikojnë drejtpërdrejtë në transparencën proaktive të autoriteteve publike, si dhe rrisin besueshmërinë dhe llogaridhënien e tyre për publikun.



KONFERENCA “PARANDALIMI I KORRUPSIONIT DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR”

Me temën “Parandalimi i korrupsionit dhe bashkëpunimi ndërkombëtar” u mbajt Konferenca e bashkëorganizuar nga Ministria e Drejtësisë, Autoriteti Kombëtar Anti Korrupsion i Italisë (*Autorita Nazionale Anti Corruzione-ANAC*) dhe Ambasada e këtij vendi në Shqipëri. I ftuar në këtë aktivitet ishte dhe Komisioneri, z. Besnik Dervishi.



Në konferencë referuan ministri i Drejtësisë, z. Ulsi Manja, Presidenti i ANAC, z. Giuseppe Busia, Ambasadori z. Fabrizio Bucci, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Arben Shehu dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik, znj. Reida Kashta. Në fjalën e tij përshëndetëse, Komisioneri vlerësoi se zbatimi i detyrimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit nxit transparencën

dhe llogaridhënien e Autoriteteve Publike, duke ndikuar drejtpërdrejtë në cilësinë e luftës kundër korrupsionit në administratën publike.

*“Aksesi në informacion cilësohet ndryshe si oksigjeni i demokracisë dhe si i tillë, institucionet publike duhet ta ofrojnë atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët, me qëllim që të garantojnë një përdorim sa më efektiv të tij. Ky proces mbështetet në 5 parime të rëndësishme: **aksesi maksimal**, nënkupton se, institucionet publike kanë detyrimin të japin informacion dhe se çdo shtetas ka të drejtë ta kërkojë atë; **autoritetet publike janë të detyruara të publikojnë informacionet e rëndësishme për publikun** (buxheti, auditime, prokurime publike, vendimmarrja, etj); **institucionet publike duhet të promovojnë qeverisjen e hapur; përjashtimet nga e drejta për informim duhet të jenë të qarta dhe të sakta** dhe t’i nënshtrohen testit të “interetit publik” dhe testit të “dëmit të shkaktuar”; si dhe **kostot për marrjen e dokumentacionit duhen reduktuar drejt zerimit të tyre**. Synimi i ndërthurjes së konceptit të antikorrupsionit me atë të transparencës është që, përmes këtij kombinimi të formohet një figurë e një administrate publike sa më transparente, e plotë, e pastër dhe e lirë nga ndikimet e mundshme të paligjishme të çdo dukurie të natyrës korruptive”* – theksoi ndër të tjera z. Dervishi.

“DITËT E TRANSPARENCËS” ME AUTORITETE PUBLIKE TË LEZHËS, ELBASANIT, BERATIT DHE KUKËSIT

Zyra e Komisionerit po zhvillon iniciativën “Ditët e Transparencës”, e cila ka si objektiv vlerësimin e ecurisë të zbatimit të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

me qëllim garantimin e kësaj të drejte dhe nxitjen e transparencës proaktive e llogaridhënies së institucioneve publike. Deri tani, janë zhvilluar aktivitetet në Lezhë, Elbasan, Berat dhe Kukës, ku dy të fundit janë bashkëorganizuar me ambasadën e Britanisë së Madhe. Në këto takime morën pjesë



prefektët, kryetarë të bashkive qendër-qarku, drejtues/përfaqësues të njësive të tjera të vetëqeverisjes vendore, nga organet e sistemit të drejtësisë, nga strukturat rajonale të institucioneve të varësisë, si dhe koordinatorët e tyre për të drejtën e informimit.



Lezhë



Elbasan

Përbushja e detyrimeve rregullatore është faktor përmirësues edhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve që ofrohen për qytetarët. Nga monitorimi dhe analiza e situatës, Zyra e Komisionerit konstaton domosdoshmërinë për efektivitet më të madh në përditësimin e Programit

të Transparencës dhe Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, sidomos, duke i kushtuar vëmendje shpenzimeve buxhetore, procedurave të prokurimit publik apo auditimeve dhe procesit të njoftimit dhe konsultimit publik.

Në këto takime u kërkua nga koordinatorët angazhim për rritjen e cilësisë në procesin e trajtimit të kërkesave për informacion nga qytetarët apo grupet e interesit, si dhe për konsolidimin e një bashkëpunim konstant me ta për forcimin e kulturës së transparencës. Stafi i Zyrës së Komisionerit shpërndau për qytetarët materiale ndërgjegjësuese për ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim, në disa stenda informuese.



Kukës



KONSULTIMI PËR PËRMIRËSIMET NË LIGJIN “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”

Zyra e Komisionerit bashkë-organizoi me organizatën “Lëviz Albania” tryezën konsultuese për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të shoqërisë

civile, medias dhe koordinatorë të të drejtës për informim të institucioneve qendrore, të pavaruara e të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Në takim u vlerësua ecuria e përgjithshme në përmbushjen e detyrimeve të ligjit nr. 119/2014, në ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve, në nxitjen e kulturës së transparencës dhe në rritjen e përgjegjshmërisë e llogaridhënies së autoriteteve publike. Problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të tij, por dhe sugjerimet e organizatave të shoqërisë civile sollën domosdoshmërinë e përmirësimeve/ndryshimeve në legjislacionin e fushës. Ndër përmirësimet më kryesoret të tij janë:



- konsolidimi i rolit, funksioneve dhe kompetencave të Zyrës së Komisionerit;
- krijimi i një Bordi Këshillimor si një mekanizëm rekomandues mbi zbatimin sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të ligjit;
- përfshirja në Programin e Transparencës të vendimmarrjes së organeve të prokurorisë për veprat penale që kanë interes të lartë publik;
- mundësinë e sanksionimit të personit përgjegjës për refuzimin e dhënies së informacionit, përveç rasteve kur përgjegjës është koordinatori;
- përfitimin e një shtesë page për natyrë të veçantë pune për koordinatorin për të drejtën e informimit.

Në këtë tryezë u diskutua gjerësisht për propozimet në projektligj me synim shtrirjen e konsultimit në nivel teknik dhe zgjerimit të pjesëmarrjes së aktorëve/grupeve të interesit në këtë proces, i cili vijon edhe në 6-mujorin e dytë të vitit, në mënyrë që akti të miratohet nga Kuvendi brenda 2022.



KUVENDI MIRATON REZOLUTËN PËR VLERËSIMIN E PUNËS TË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2021

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, në seancën plenare të datës 28 prill 2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqiti Raportin Vjetor të veprimtarisë së institucionit për vitin 2021.

Në përputhje me procedurën, Kuvendi miratoi dhe Rezolutën “Për vlerësimin e punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2021”. Më herët gjatë këtij muaji, Raporti u paraqit dhe mori vlerësimin nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT ME AGJENCINË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI TË KOSOVËS

Me ftesë të Komisionerit, z. Besnik Dervishi, zhvilloi vizitën e saj në Tiranë Komisionerja e Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) të Kosovës, znj. Krenare Sogojeva-Dërmaku. Qëllimi i vizitës ishte nënshkrimi i një Marrëveshje Bashkëpunimi me karakter teknik midis dy institucioneve, të cilat gëzojnë një marrëdhënie të veçantë mes tyre, por që në sajë të kësaj Marrëveshje, do të konsolidohet e zhvillohet edhe më shumë.



Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet mbi tre shtylla kryesore: shkëmbimin periodik të eksperiencave dhe stafit për rritjen e kapaciteteve profesionale e administrative, në kuadër të modernizimit të legjislacionit në të dy fushat e veprimtarisë sipas standardeve më të përparuara evropiane; mbështetjen ndaj AIP për anëtarësimin në organizata të ndryshme, si Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (ICIC), Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA), Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës (T-PD), etj; si dhe në njohjen e ndërsjellë si shtete me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale (*adequacy*), për një zhvillim të qendrueshëm të ekonomisë dhe shkëmbimit midis dy vendeve.

Komisioneri Dervishi cilësoi se *“kemi një produkt konkret dhe uroj që ky bashkëpunim të jetë tejet i suksesshëm në të ardhmen. Secili prej institucioneve ka përvojën e vet të akumuluar gjatë viteve të veprimtarisë, por mendoj se kemi çfarë të shkëmbejmë me njëri-tjetrin”*. Komisionerja Sogojeva-Dërmaku tha se *“synimi i dy vendeve tona është integrimi në BE dhe çdo eksperiencë është e mirëseardhur, sidomos, në këtë fazë kur legjislacioni është në harmoni me politikat evropiane”*.

Gjatë takimit, u diskutua edhe për mundësinë e zbatimit të projekteve të përbashkëta. Ato kanë si qëllim forcimin e besimit e ndërgjegjësimin për ushtrimin e të drejtave nga qytetarët, paralelisht, me rritjen e transparencës e llogaridhënies së autoriteteve publike dhe përgjegjshmërisë e etikës nga kontrolluesit/përpunuesit publik e privat. Komisionerët vlerësuan dhe ndanë të njëjtin qëndrim se kjo Marrëveshje është një hap shumë i rëndësishëm dhe nisja e një etape të re dinamike në marrëdhëniet dy-palëshe.



Znj. Sogojeva-Dërmaku u prit në takime të veçanta edhe nga Nënkryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Felaj dhe Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca.



KONFERENCA “MOS U RREJ! DITA NDËRKOMBËTARE E VERIFIKIMIT TË FAKTEVE NË SHQIPËRI”

Zyra e Komisionerit ishte e ftuar në Konferencën Kombëtare “Mos u rrej! Dita Ndërkombëtare e Verifikimit të Fakteve në Shqipëri” të organizuar nga “Faktoje.al”. Në fjalën e tij përshëndetëse z. Besnik Dervishi e vuri theksin në bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë

civile dhe median, si një faktor për rritjen e kulturës së transparencës dhe ofrimin e shërbimeve me standarde nga administrata publike.

“Faktoje.al është një nga grupimet më aktive të viteve të fundit dhe që e ka mirëpërdorur të drejtën për informim, e cila është e lidhur ngushtë me lirinë e shprehjes. Thelbësor është fakti se Shqipëria ka një legjislacion modern. Forcimi i marrëdhënieve me shoqërinë civile dhe median, veçanërisht me atë investigative, është i rëndësishëm dhe vlerësoj, se këto grupime kanë gjetur te Zyra e Komisionerit një institucion publik me të cilin diskutohet hapur. Nga ana tjetër, autoriteti nëpërmjet vendimmarrjes ka dhënë kontribut me jurisprudencë në këtë fushë, e cila duhet zhvilluar e konsoliduar më tej” – tha ndër të tjera z. Dervishi.



BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE PËR ZBATIMIN E TË DREJTËS PËR INFORMIM

Zyra e Komisionerit zhvilloi takime me organizatat e shoqërisë civile “Qëndresa qytetare” dhe “Mjaft”. Në fokus të tyre ishte vlerësimi i ecurisë së zbatimit të legjislacionit

të fushës dhe bashkëpunimi në kuadër të projekteve që forcojnë dhe nxisin transparencën dhe llogaridhëniën e autoriteteve publike. Me organizatën “Qëndresa qytetare” u diskutua për veprimtarinë e institucioneve të sektorit shëndetësor dhe për ato të arsimit të lartë. Veçanërisht, u trajtuan çështje për adresimin e problematikave të konstatuara për kërkesat/ankesat në raport me këto autoritete publike. Me interes, u diskutua edhe për mundësinë e nisjes së një konsultimi më të gjerë për krijimin e një Programi Transparence të dedikuar për institucionet arsimore të të gjitha niveleve.

Me organizatën “Mjaft” bashkëbisedimi u fokusua në ecurinë e zbatimit të projektit “Përgjegjshmëria, teknologjia dhe hapja institucionale në Shqipëri”. Në takim u shkëmbyen mendime edhe për mundësinë e angazhimit të autoritetit në këtë projekt dhe në përgjithësi, për forcimin e kulturës së transparencës së administratës.



PREZANTIMI I REZULTATEVE TË PYETËSORIT



Zyra e Komisionerit zhvilloi në muajin maj takimin për “*Prezantimin e rezultateve të Pyetësit për vlerësimin e njohurive të autoriteteve publike në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale*”. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm mbi 100 përfaqësues dhe nëpunës të

mbrojtjes së të dhënave personale nga institucione qendrore, të pavarura dhe të vetëqeverisjes vendore.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, theksoi se “*ofrimi i shërbimeve online dhe zhvillimi i teknologjisë, imponojnë një reformë të plotë dhe të strukturuar edhe në këtë fushë. Hapi i parë është modernizimi i legjislacionit, proces i cili do të përmbyllet brenda këtij viti. E rëndësishme është, gjithashtu, dhe edukimi me konceptet e parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, ku Zyra e Komisionerit synon integrimin e tyre në kurrikulën e sistemit arsimor të vendit.*”



Rezultatet e Pyetësit u prezantuan nga znj. Pjerina Gaxha, Drejtori i Përgjithshëm i Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Target-grupi i Pyetësit ishin veçanërisht punonjësit që për shkak të detyrës së tyre funksionale kryejnë apo përfshihen në mënyrë të pashmangshme në procesin e përpunimit të të dhënave personale. Sipas të dhënave atë e plotësuan mbi 1700 nëpunës. Nëpërmjet tij identifikohet

niveli i njohurive të kontrolluesve publik mbi parimet në të cilat bazohet përpunimi i të dhënave personale, apo mbi koncepte si pëlqimi i qytetarit (subjekti i të dhënave personale) dhe të drejtat që i garanton atij legjislacioni. Pjesëmarrësit sipas statistikave u grupuan përkatësisht në: 50% nëpunës të institucioneve qendrore, 13% nga institucione të vetëqeverisjes vendore, 21% nga institucione të pavarura dhe 16% i përkasin subjekteve të tjera publike.

Zyra e Komisionerit konstaton se njohja në tërësi e legjislacionit është jo e duhura dhe sidomos, kërkohet vëmendje e shtuar për rritjen profesionale, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme. Pjesë e këtij aktiviteti ishte dhe një prezantim për funksionet e “*nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale*”, i cili me hyrjen në fuqi të kuadrit të ri rregullator të fushës do të ketë rol specifik brenda strukturës së autoriteteve publike apo subjekteve private që mbledhin dhe përpunojnë të dhëna. Së shpejti, Shqipëria do të ketë një legjislacion modern e bashkëkohor të përafuar tërësisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), duke parashikuar standardet më të larta në garantimin e kësaj të drejte dhe lirie themelore të individit.

KONSOLIDIM I ROLIT TË INSTITUCIONIT PËR GARANTIMIN E TË DREJTAVE TË QYTETARËVE



Z. Besnik Dervishi, zhvilloi një takim pune me znj. Elisa Spiropali, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Fokusi i tij ishte forcimi i mbështetjes për garantimin sa më efektiv të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve nëpërmjet zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Komisioneri dhe stafi paraqitën një panoramë të kuadrit rregullator për fushat e veprimtarisë, atë ekzistues si dhe punën për modernizimin e tij. Në lidhje me këtë të fundit, u diskutuan modalitetet për forcimin e bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për përshpejtimin e procesit të ndryshimeve ligjore, të harmonizuara me standardet më bashkëkohore evropiane. Në takim u diskutuan edhe çështje të forcimit të kapaciteteve administrative të autoritetit, për të adresuar problematika të konstatuara ndër vite dhe për t’iu përgjigjur zhvillimit ekonomik e shoqëror. U vlerësuan edhe iniciativat bashkëpunuese për konsolidimin e kulturës së transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve dhe garantimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në mirëqeverisje.



WORKSHOP ME SHOQATËN DIHA, PËR TË ZBATIMIN E TË DREJTAVE NË FUSHËN E BIZNESIT

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Shoqatën Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA), zhvilluan workshop-in “*E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në fushën e biznesit*”. Pjesëmarrës në

këtë aktivitet ishin përfaqësues nga subjekte/shoqëri anëtare të kësaj organizate, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fusha e sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Si dy të drejta dhe liri themelore kushtetuese, ato garantohen nga një kuadër rregullator bashkëkohor, bazuar në praktikën legjislative evropiane. Të pranishmit u njohën me rolin, funksionet dhe kompetencat e Zyrës së Komisionerit, si dhe drejtimit kryesor të veprimtarisë mbikëqyrëse. E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale bazohen mbi parimet e etikës, përgjegjshmërisë, llogaridhënies, integritetit dhe transparencës. Autoritetet publike dhe kontrolluesit publik/privat kanë detyrime rregullatore konkrete për t’i përmbushur për të lehtësuar ushtrimin në praktikë të këtyre të drejtave nga qytetarët. Transparenca proaktive e institucioneve publike është një nga drejtimit kryesor për një administratë dinamike. Ndërsa, masat e nevojshme tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale janë edhe më të dosmodoshme në epokën digjitale ku jetojmë. Këto standarde nxisin e forcojnë besimin e qytetarëve për marrjen e shërbimeve në kohë e me cilësi. Workshopin e bashkëdrejtoi znj. Besa Velaj, Drejtore e Kabinetit në Zyrën e Komisionerit.

ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DETYRIM PËR ÇDO KONTROLLUES

Zyra e Komisionerit në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale monitoron me seriozitet aktivitetin e kontrolluesve duke vlerësuar me kujdes çdo rast të cenimit apo shkeljes së kësaj të drejte dhe lirie themelore të individit.



Zyra e Komisionerit, në përmbushje të detyrimeve të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi u ka kërkuar subjekteve që e ushtrojnë veprimtarinë në sektorin mediatik dhe/ose individëve/entiteteve të tjera që përdorin mjete/forma të komunikimit masiv, që të mos përhapin apo shpërndajnë informacion personal/sensitiv apo detaje të panevojshme për çështje që nuk përbëjnë dhe nuk i shërbejnë aspak *“interesi më të lartë publik”*.

Duke marrë shkas nga pasqyrimi mediatik i një ngjarjeje familjare, Zyra e Komisionerit vlerëson se publikimi i pamjeve dhe videove përbën cenim të jetës private me pasoja të rënda, të pariparueshme dhe të pakthyeshme e ku përveç dhunës fizike të ushtruar ndaj individëve të përfshirë, këta qytetarë mund të përballen me dhunën mediatike, e cila për nga përmasat e pasojave është po aq e rëndë sa vetë aktet e dhunës të ushtruar ndaj tyre.

Duke vlerësuar rolin e medias për ekspozimin e fenomeneve negative, Zyra e Komisionerit u ka bërë thirrje të gjitha organeve mediatike - audio/vizive, të shkruara, online - që të tregohen të vetëdijshme për detyrimet në respektimin e kësaj të drejte individuale. *“Interesi më i lartë publik”* ka përparësi mbi çdo përpjekje për t’i kthyer situata të caktuara në lojra shumë të rrezikshme për cenimin e privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarëve. Po ashtu, opinioni publik duhet të tregoj kujdes të shtuar dhe të jetë i ndërgjegjësuar për të refuzuar përfshirjen në përdorimin/përhapjen e paligjshme të të dhënave nëpërmjet çdo forme të komunikimit masiv.



Ushtrimi i të drejtës së lirisë së shprehjes nuk është i pakufizuar dhe bëhet nga vlerësimi i saktë, i balancuar e proporcional me të drejtat dhe liritë e tjera themelore të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, apo në aktet ndërkombëtare ku vendi ynë është palë: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Konventa 108 “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale” e Këshillit të Evropës, etj.

Zyra e Komisionerit çmon dhe thekson se organet mediatike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në funksion *“të interesit publik”*, duhet të përmbushin me përgjegjshmëri, transparencë dhe etikë si normat vetërregulluese ashtu edhe parashikimet e legjislacionit në fuqi për mos cenimin e të drejtës për jetë private.

PROCESI I NEGOCIATAVE, VLERËSOHET KONTRIBUTI I ZYRËS SË KOMISIONERIT

Në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian 2022, u zhvillua takimi konsultativ me temë “Përgatitja e ekzaminimit dypalësh” (*Preparing the Bilateral Screening*). Me pjesëmarrjen e Kryenegociatorit, z. Zef Mazi dhe të përfaqësuesve nga institucione të



ndryshme qendrore, të varësisë dhe të pavarura, të përfshira në Ekipin Negociator, aktiviteti kishte për qëllim ushtrimin/simulimin e një seance bisedimesh me zyrtarët e BE. Duke qenë se ky është një proces kompleks dhe i gjatë, workshop-i synoi rritjen e aftësive komunikuese dhe forcimin e bashkëveprimit të Ekipit Negociator. Zyra e Komisionerit u përzgjedh si një nga prezantuesit kryesorë për këtë simulim, ku u paraqit gjendja aktuale dhe sidomos, veprimtaria për modernizimin e legjislacionit të fushave të saj të përgjegjësive sipas standardeve më bashkëkohore evropiane. Të pranishmit vlerësuan kontributin e institucionit, si dhe shkëmbyen mendime në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të paraqitjes së Ekipit Negociator shqiptar. Takimi ishte pjesë e Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje procesit të integrimit të Shqipërisë në BE” (*Support to the EU integration process of Albania*).



TË INFORMUAR E NDËRGJEGJËSUAR, TAKIME ME STUDENTË

Zyra e Komisionerit i kushton rëndësi ndërveprimit me institucionet e arsimit të lartë në kuadër të veprimtarisë mësimore akademike të rinjve, si dhe për zgjerimin e njohurive të tyre, si profesionistë të së ardhmes. Disa aktivitete u organizuan me këtë qëllim me pjesëmarrjen e studentëve nga Fakultetet e

Drejtësisë dhe Ekonomik të Universitetit të Tiranës, nga Universiteti Mesdhetar, si dhe atyre të grupuar në shoqatën Roma Versitas Albania. Në këto aktivitete u prezantua legjislacioni në fuqi për të dy fushat e përgjegjësive së institucionit, veprimtaria mbikëqyrëse nëpërmjet prezantimit të rasteve konkrete, si dhe u dhanë këshilla të vlefshme për ushtrimin në praktikë të këtyre të drejtave nga qytetarët. Zyra e Komisionerit është përherë e hapur për të bashkëpunuar me organizata e grupe interesi në funksion të forcimit të kulturës së ndërgjegjësimit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Tryezë diskutimi organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit me temë “Vështrim ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të reflektuara në databazat e administruara nga shteti dhe pajtueshmërinë e tyre me “*acquis communautaire*”.



ZYRA E KOMISIONERIT ORGANIZATORE E EDICIONIT TË 15-TË TË KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE TË KOMISIONERËVE TË INFORMIMIT (ICIC)

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u përzgjedh të organizojë edicionin e 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (*International Conference of Information Commissioners - ICIC*), që do të mbahet në pranverën e vitit 2024. Me votim unanim anëtarësia e organizatës miratoi, gjatë punimeve të Sesionit të Mbyllur të Konferencës së Meksikës, propozimin e Komitetit Ekzekutiv.



Besimi për organizimin e këtij aktiviteti është një përgjegjësi për Zyrën e Komisionerit, për promovimin e kulturës së transparencës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri dhe më gjerë, në rajonin tonë. Nga ana tjetër, mbajtja e Konferencës së ICIC në 2024 është gjithashtu, një simbolikë e fortë për një vend ku mendësia e fshehtësisë së veprimtarisë së administratës shtetërore ka rrënjë të thella dhe ku po bëhen përpjekje për një shoqëri më të hapur, falë sinergjive të përbashkëta të autoritetit mbikëqyrës, organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe publikut të gjerë. Edicioni i 15-të i ICIC do të jetë pikë e rëndësishme takimi për avancimin e objektivave të organizatës, duke siguruar lidhje të qëndrueshme me Konferencat e mëparshme, nëpërmjet gjithëpërfshirjes së anëtarësisë së saj.

Eksperiencia e përfituar në organizimin e takimeve madhore botërore, si në rastin e Asamblesë Globale të Privatësisë të vitit 2019, dëshmoi mundësitë dhe aftësitë e një autoriteti të vogël por dinamik. Konferenca e ICIC 2024 do të jetë kontribut, jo vetëm, për promovimin e vendit, mikpritjes së tij, por edhe angazhim për forcimin e zbatimit të një të drejte e lirie themelore dhe zgjerimin e transparencës së autoriteteve publike.

Takim pune me “Qendrën për Çështjet e Informimit Publik” (InfoÇip) për koordinimin e projekteve të përbashkëta.



“AKSESI NË INFORMACION, PJESËMARRJA DHE PËRFSHIRJA NË EPOKËN DIGJITALE”, KONFERENCA E 13-TË E ICIC

Në datat 22-24 qershor, u zhvillua në Puebla të Meksikës edicioni i 13-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (*International Conference of Information Commissioners - ICIC*), nën organizimin e Autoritetit Federal për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të këtij vendi (INAI).



Ky takim i përvitshëm është forumi kryesor dhe më i rëndësishëm në rang botëror për trajtimin e problematikave lidhur me nxitjen dhe forcimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies së autoriteteve publike. Tematika e kësaj Konference ishte “*Akresi në informacion, pjesëmarrja dhe përfshirja në epokën digjitale*” dhe ku punimet e saj u ndoqën në format hibrid (fizikisht/online) nga përfaqësues të të gjitha autoriteteve anëtare të organizatës, organizmave partnere, bota akademike, shoqëria civile, media, etj.



Sesioni i Mbyllur i ICIC u mbajt më datë 24 qershor, në të cilin u diskutua gjerësisht mbi veprimtarinë përgjatë 12 muajve të kaluara dhe ku anëtarësia miratoi Raportin Vjetor; ndërsa u realizuan raportimet respektive të Grupeve të Punës apo Rajonale mbi zhvillimet kryesore në këtë fushë. Zyra e Komisionerit është anëtare në dy nga Grupet e Punës, atë për Promovimin e Transparencës Proaktive dhe mbi Trajnimet. Dy autoritete të reja nga kontinenti afrikan iu bashkuan ICIC, Komisioni për Aksesin në Informacion

i Bregut të Fildishtë dhe Institucioni i Avokatit të Popullit të Etiopisë, duke e çuar në 73 numrin e anëtarësisë së institucioneve kombëtare/rajonale në këtë organizatë.

Sesioni i Hapur i Konferencës i mbajti punimet në datat 22-23 qershor, në të cilin u trajtuan një sërë çështjesh dhe u zhvilluan diskutime për sfidat e informacionit publik dhe transparencës në raport me inteligjencën artificiale (AI) apo me *cloud* dhe *blockchain*. Po ashtu, interes patën edhe trajtimi i temave në lidhje me aksesin në dokumentacionin publik, dezinformimin dhe lirinë e shtypit/medias në epokën digjitale apo transparencën proaktive, si mjet efikas në promovimin dhe rritjen e hapjes së institucioneve. Njëkohësisht në këtë Konferencë, u mbajtën një sërë aktiviteteve paralele dhe seminare të organizuara nga UNESCO, grupet ndërkombëtare të punës dhe rrjetet e ndryshme rajonale.

BASHKËPUNIMI RAJONAL NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE, TAKIM I AUTORITETEVE NË PRISHTINË

Forcimi i bashkëpunimit mes autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, ishte qëllimi i organizimit të takimit të mbajtur në Prishtinë. Mikpritëse e aktivitetit të parë të këtij formati ishte Agjencia për Informim dhe Privatësi e Kosovës, përfaqësuar nga Komisionerja, znj. Krenare



Sogojeva-Dërmaku. Ndërsa, nga autoritetet e tjera morën pjesë znj. Besa Velaj, Drejtore e Kabinetit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; z. Muhamed Gjokaj, Kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit të Malit të Zi dhe znj. Leonora Kadriji, Sekretare e Përgjithshme e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Maqedonisë së Veriut.



Diskutimet e të pranishmëve u përqendruan në shkëmbimin e përvojave më të mira në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe përshkrimin e trajtimit të rasteve konkrete në sektorët e sigurisë, shëndetësisë, arsimit apo dhe telekomunikacionit. Në këtë takim, vëmendje iu kushtua procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR), për zbatimin

e standardeve më bashkëkohore evropiane për qytetarët në secilin shtet të rajonit. Njëkohësisht, delegacionet vlerësuan të gjitha mundësitë për thellimin e bashkëveprimit ndërinstitucional, shkëmbimet e eksperiencave dhe stafeve, si dhe adresimin e problematikave dhe sfidave të përbashkëta për respektimin e kësaj të drejte e lirie themelore.

Krerët e delegacioneve u pritën në një takim të veçantë nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca. Në të u theksua rëndësia e fushës së mbrojtjes së të dhënave personale duke balancuar respektimin e kësaj të drejte me zhvillimin e qendrueshëm ekonomiko-shoqëror, si dhe u vlerësuan përpjekjet për rritjen e nivelit të sigurisë përballë zhvillimeve teknologjike dhe globalizimit digjital të shkëmbimit të informacionit.





Top Channel



Euronews Albania

**KOMISIONERI
NË MEDIA**



Scan Tv

Revista “Informim Dhe Privatësi”

**Përgatitet dhe botohet nga
Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Qershor 2022**



**Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5
Kodi postar 1001
Tiranë**

**Tel: +355 42237200
Nr. i gjelbër: 08002050
www.idp.al
info@idp.al**